



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology
Kabinet i Ministrat /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 përfushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrite (22.03.2011), nxjerr:

Udhëzimi Administrativ

Qendrat e Kompetencës (QK) në Kosovë

NUMËR: 05/2012

DATË : 02.05.2012

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim administrativ rregullon qëllimet, strukturën dhe funksionet e Qendrave të Kompetencës(QK), brenda sistemit kosovar të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) dhe integrimin e tyre në kontekstin e AAP evropian.

Neni 2 **Funksionet**

Qendrat e Kompetencës janë institucione të reja në sistemin e AAP të Kosovës. Qëllimi dhe funksioni i tyre është të ofrojnë punëtorë të kualifikuar me njohuri dhe shkathtësi praktike që u përgjigjen nevojave të tregut të punës në Kosovë dhe BE. QK ofrojnë AAP fillestare dhe të mëtutjeshëm dhe programet e tyre arsimore dhe aftësuese mund tu dedikohen të rinxve dhe të rriturve me ose pa kualifikim formal paraprak.

Neni 3 **Korniza e përgjithshme e QK**

1. QK është institucion i AAP i cili duhet të regjistrohet dhe certifikohet si QK nga MASHT. Për tu regjistruar si kandidat për QK kërkohet plotësimi i kritereve minimale në vazhdim:
 - 1.1. Kapacitete adekuate të punëtorive / laboratoreve duke përfshirë materialet mësimore dhe pajisjet për lëndët (profilet) përkatëse.
 - 1.2. Personel të kualifikuar menaxhues dhe mësimdhënës.
 - 1.3. Struktura menaxhuese në pajtim me këtë udhëzim administrativ.
 - 1.4. Planin zhvillimor të shkollës duke përfshirë planin aksional për implementimin e hapave të domosdoshëm për të plotësuar kërkesat e QK në pajtim me këtë Udhëzim administrativ.
2. Institucionet e AAP të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e Udhëzimit administrativ do të certifikohen si QK nga MASHT.
3. MASHT përkrah shkollat e AAP në procesin e regjistrimit deri në certifikim. Procesi duhet të jetë transparent. Kohëzgjatja maksimale ndërmjet regjistrimit dhe certifikimit është 5 vite.
4. Para regjistrimit si kandidat për QK, shkolla që aplikon duhet të bëjë një vetëvlerësim bazuar në kriteret e ofruara nga MASHT. MASHT bën vlerësimin e saj duke u bazuar në vetëvlerësimin e shkollës. Rezultatet e këtij vlerësimi përbëjnë themelin për planin zhvillimor të shkollës. Deri në certifikim, MASHT monitoron dhe vlerëson përmbushjen e synimeve të vendosura në planin zhvillimor të shkollës në baza vjetore.
5. Për të mbajtur statusin si QK e certifikuar, MASHT bën vlerësimin e shkollës bazuar në kriterje transparente çdo tri vite. Nëse QK e certifikuar dështon të ruaj standardet – do të rivlerësohet në vitin vijues. Nëse standardet nuk përmbushen gjatë vitit, statusi si QK e certifikuar do të tjerhiqet.

Neni 4 **Qeverisja e Qendrave të Kompetencës**

1. QK dhe shkollat profesionale duhet të qeverisen dhe administrohen nga Agjicioni për Arsim dhe Aftësim Profesional i Kosovës (AAAPK), i cili duhet të themelohet.
2. AAAPK është një institut që funksionon nën autoritetin e MASHT.
3. Deri në themelimin e AAAPK do të zbatohen rregullat e përkohshme si në vijim:
 - 3.1. Detyrat e AAAPK realizohen nga Departamenti i Administratës të Arsimit Parauniversitar (DAAP) të MASHT. Përgjegjësitë dhe detyrat aktuale të komunave do të aplikohen deri në themelimin e AAAPK. Tranzicioni gradual i përgjegjësive në AAAPK bëhet në konsultim të ngushtë me komunitat.

4. Departamenti i Administratës të Arsimit Parauniversitar (DAAP) i MASHT do të punësojë personel profesional që korrespondon me fushat përkatëse të arsimit / aftësimit të QK me qëllim mbështetjen, koordinimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të QK. Ky personel do të merret edhe me komunikimin dhe bashkëpunimin me komunat përkatëse.

5. Struktura dhe detyrat e AAAPK.

5.1. Struktura dhe detyrat finale të AAAPK do janë rezultat i zhvillimeve gjatë fazës tranzicinale.

5.2. Faza tranzicionale nuk do duhej të ishte më e gjatë se dy vite, filluar nga data e aprovimit të këtij Udhëzimi administrativ.

6. Bordet shkollore të QK. Në bordet shkollore të QK janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë të dyja subjektet, atë publik dhe privat. Detyrat e bordit të shkollës do të definohen saktësisht gjatë procesit zhvillimorë.

7. Bashkëpunimi ndërmjet vendmësimeve (vendaftësimeve). Në QK ngriten platforma të orientuara në profesione për përkrahjen e bashkëpunimit në mes të ndërmarrjeve përkatëse dhe QK.

Neni 5
Menaxhmenti dhe administrata

1. QK janë institucione nationale. Të gjitha QK kanë struktura të njëjtë menaxheriale dhe administrative.

2. Strukturat organizative të QK përbëhen nga një bord menaxhues, drejtoria, mësimdhënësit me funksione speciale, mësimdhënësit e rregullt dhe personeli administrativ.

3. Përbërja dhe funksioni i bordit do të definohet si përshkruar në nenin 4 pikë 4.3.

4. Drejtoria- Menaxhmenti i QK përbëhet nga një drejtore dhe dy zëvendësdrejtorë.

5. Drejtori mban përgjegjësinë e përgjithshme për operimin ditor dhe zhvillim, për aspektet pedagogjike dhe administrative si dhe për aktivitetet në gjenerimin e të ardhurave dhe kontaktet e bashkëpunimit me sektorin e biznesit, MASHT (AAAPK) dhe QK dhe shkollat tjera të AAP.

6. Zëvendësdrejtori është përgjegjës për:

6.1. Sigurimin e ofrimit të AAP të kualitetit të lartë;

6.2. Vlerësimin dhe regjistrimin e arritjeve të nxënësve në pajtim me rregullat nationale;

6.3. Çështjet ekonomike dhe financiare duke përfshirë aktivitetet për krijimin e të ardhurave;

6.4. Sigurimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit të mirë me kompanitë private përkatëse dhe institucionet publike;

6.5. Komunikim dhe marrëdhënie ndërkombëtare.

7. Mësimdhënësit me funksione speciale caktohen nga tre drejtorët në bazë të shkathtësive dhe sjelljeve personale të demonstruara:

7.1. Udhëheqësi i sektorit: QK është e organizuar në sektorë sipas fushës së arsimit dhe aftësimit. Në secilin sektor, një mësimdhënës me përvojë do të ketë funksionin e udhëheqësit te sektorit. Ai ose ajo ka përgjegjësi koordinuese për punë praktike, administrative, arsimore dhe zhvillimore në fushën përkatëse të arsimit dhe aftësimit.

7.2. Këshilltarët për karrierë: dy mësimdhënës do të kenë funksionin e këshilltarëve në karrierë. Ata do shpenzojnë një pjesë të kohës së tyre për të ofruar informata dhe shërbime tjera për mundësitet arsimore, tregun e punës, zhvillimin e tregut të punës dhe mundësitet për punësim e vetëpunësim.

8. Detyrat administrative të përshkruara nën 7.1 dhe 7.2, kryhen në kuadër të fondit të orëve të mësimdhënësve përkatës. Mësimdhënia dhe detyrat tjera duhet të përshtaten në mes vete.

9. Mësimdhënësit e rregullt:

- 9.1.** Mësimdhënësit e AAP janë përgjegjës për ofrimin e AAP të kualitetit të lartë dhe përgatitjen e nxënësve për punë praktike, për punësim ose vetëpunësim.
- 9.2.** Mësimdhënësit e lëndëve joprofessionale bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit e AAP dhe e japid lëndën në atë mënyrë që përkrah zhvillimin profesional të nxënësve.
- 10.** Personeli administrativ: QK ka personel adekuat administrativ, për kontabilitet dhe sigurim.

Neni 6
Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënësve dhe menaxhmentit

1. Qendrat e Kompetencës kanë sistem të njëjtë dhe transparent të zhvillimit të burimeve njerëzore. Zhvillimi i burimeve njerëzore do të bazohet në nevojat individuale të mësimdhënësve dhe Qendrës së Kompetencës.
2. Personeli mësimdhënës, trajnues dhe menaxherial i QK duhet tu nënshtrohet trajnimeve përkatëse për së paku 5 ditë në vit. Menaxhmenti do të vendoë për trajnimet shtesë sipas nevojës dhe interesit të QK dhe personelit si dhe buxhetit në dispozicion.
3. QK ofron vazhdimesh zhvillim të brendshëm të kapaciteteve, për shembull në fushën e teknologjisë informative, gjuhëve dhe metodologjisë së mësimdhënies përmes ekspertëve të saj në fushën përkatëse. Së paku 20% e vendeve do të rezervohen për pjesëmarrësit nga Qendrat tjera të Kompetencës dhe shkollave tjera të AAP.

Neni 7
Nivelet e kualifikimit

1. QK si kualifikim kryesor ofrojnë programe të AAP të nivelit të 3 të Kornizës Kombëtare për Kualifikime.
2. Përveç kësaj, QK ofrojnë kualifikime për nivele të tjera dhe grupe të ndryshme të të rinjve dhe të rriturve, sipas kërkesave të institucioneve publike dhe kompanive private.
 - 2.1. Nxënësve do tu jepen kredi për përfundim të suksesshëm të moduleve, në pajtim me rregulloret e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.
 - 2.2. QK në pajtim me rregulloret kombëtare aplikojnë sistemin e vlerësimit dhe akreditimit të mësimit paraprak (AMP) dhe përvojës paraprake (APP)
3. QK ofrojnë kualifikime të nivelit 4 të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Neni 8
Kurrikulat

1. Të gjitha kurrikulat të cilat shpien në kualifikim formal duhet të kenë dizajn modular, të përshkruajnë rezultatet mësimore dhe të janë të akredituara nga Autoriteti Kosovar i Akreditimit.
 - 1.1. Kurrikulat e QK duhet të zhvillohen në partneritet me akterët përkatës të tregut të punës në mënyrë që të sigurohet arritja e kompetencave të nevojshme për tregun e punës.
 - 1.2. Kurrikulat e QK që shpien në kualifikim formal duhet të plotësojnë nevojat e nxënësve të nivelit sekondar dhe të janë në dispozicion për të rindjtë dhe të rriturit si pjesë e procesit të mësimit gjatë gjithë jetës.

- 1.3. Ofrimi i aftësimit (trajnimit) për të rritur duhet të adaptohet sipas nevojave specifike të një nxënësi / kandidati të rritur.
2. Kurrikulat e QK duhet të fokusohen në zhvillimin e shkathësive të kërkua të profesionale përmes praktikës gjithëpërfshirëse profesionale, dhe përkrahin një zhvillim të tillë me njoħuri të domosdoshme teorike.
3. Kurrikulat e QK të cilat shpien në kualifikim formal duhet të rishikohen shpesh sipas nevojave të ndryshueshme të tregut të punës, së paku çdo katër apo pesë vite.
4. QK zhvillojnë kurse për krijimin e të ardhurave në bashkëpunim me kompanitë / komuniteten për të plotësuar nevojat e tyre specifike, të cilat nuk duhet domosdoto të plotësojnë kriteret e Autoritetit Kosovar të Kualifikimeve.
5. Për të mundësuar mobilitetin, të gjithë nxënësit e rregullt në QK duhet të mësojnë së paku një gjuhë evropiane (anglisht, gjermanisht etj.).

Neni 9 Orientimi në tregun e punës

1. QK duhet të punojnë ngushtë me kompanitë dhe partnerët e tjera në tregun e punës.
2. QK bashkëpunojnë me partnerët në mbledhjen e informatave kualitative dhe kuantitative për nevojat e tanishme dhe të ardhshme të tregut të punës.
3. QK e adaptojnë ofrimin e aftësimeve / trajnimeve sipas nevojave të tregut të punës.
4. Partneritet mundësojnë praktika në ndërmarrje për nxënësit / kandidatët dhe mësimdhënësit e QK.

Neni 10 Menaxhimi i cilësisë

Nga të gjitha QK implementohet, vlerësohet vazhdimisht dhe azhurnohet (rishikohet) një sistem i përbashkët i menaxhimit të kualitetit. Ky sistem duhet të jetë në pajtim me Kornizën e Përbashkët Evropiane për Sigurimin e Kualitetit në AAP-(KPESK), Kornizën Kombëtare të Sigurimit të Kualitetit (KKSK) dhe kërkesat e këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 11 Aktivitetet ekonomike të QK

1. QK ofrojnë dhe organizojnë shërbime dhe aktivitete prodhuese për të krijuar të hyra. Këto aktivitete nuk duhet të dëmtojnë tregun komercial lokal.
2. QK ofrojnë aftësime të bazuara në kërkesat e tregut të punës.
3. QK ofrojnë kurse të certifikuara dhe të pa certifikuara për të rritur me ose pa kualifikim paraprak formal.
4. QK mund të konsiderojnë ofrimin me qira të hapësirave dhe pajisjeve në sasi të kufizuar me qëllim gjenerimin e të ardhurave, me kusht që të bëhet sigurimi i domosdoshëm dhe marrëveshja për kompensimin e dëmit. Megjithatë, prioritet duhet të jetë programi arsimor i QK.

Neni 12
Bashkëpunimi në mes QK-ve dhe shkollave tjera të mesme të AAP

1. QK dhe shkollat e AAP do të vendosin dhe mirëmbajnë bashkëpunim rajonal dhe sektorial në fushat vijuese:

- 1.1. Monitorimin e tregut të punës;
- 1.2. Trajnimin e mësimdhënësve dhe menaxhmentit të shkollës;
- 1.3. Zhvillimin dhe shkëmbimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore;
- 1.4. Këshillim dhe udhëzim në karrierë;
- 1.5. Marketing / panaire të AAP;
- 1.6. Shkëmbim rajonal të burimeve njerëzore.

Neni 13
Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi kombëtar dhe ndërkombëtar


1. QK duhet të zhvillojnë dhe mirëmbajnë partneritete kombëtare dhe rrjetëzime ndërkombëtare me synim përmbushjen e funksioneve dhe arritjen e qëllimeve të tyre. Partneriteti kombëtar përbën ndërmarrjet dhe institucionet private dhe publike.

2. QK duhet të kenë personel adekuat në nivelin menaxherial i cili është përgjegjës për bashkëpunimin dhe rrjetëzin kombëtar dhe ndërkombëtar.

3. MASHT promovon dhe lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave në mes QK-ve, si dhe në mes QK-ve dhe akterëve relevant të jashtëm.

Neni 14

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Prof. dr. Ramë Buja, ministër

